



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MAT
KRYETARI**

Nr. _____ Prot.

Burrel, më _____.2021

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: Operatorin Ekonomik: “NOVATECH STUDIO” Sh.p.k, me numër Nipt-i: **L01717030C**

Adresa: *Tiranë, Njësia Bashkiake nr.8, rruga “Shenasi Dishnica”, nr.pasurie 10/221+1-18, zona kadastrale 8370, hyrja 1, ap 18.*

Procedura e prokurimit: “E Hapur e Thjeshtuar - Shërbime”, prokurim elektronik

Numri i referencës së procedurës: **Loti Nr. 3: REF-95209-05-11-2021**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “**Loti Nr. 3: “Mbikqyrje të punimeve për investimin me objekt: “Rikualifikim urban i sheshit dhe fasadave të Nj. Administrative Lis dhe Komsi, Bashkia Mat”, me fond limit: 140 188 (njëqind e dyzet mijë e njëqind e tetëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH, nga grandit, dhe me afat: 60 (gjashtëdhjetë) ditë kalendarike nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit (i njëjtë me afatin e realizimit të punimeve nga shoqëria ndërtimore e cila do të zbatojë punimet).**”

Publikime të mëparshme: *nuk ka patur*

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 75, datë 17 Maj 2021

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme së, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatorin Ekonomik: “NOVATECH STUDIO” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **L01717030C**
Vlera: **116 747.9** (njëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e dyzet e shtatë pikë nëntë)
lekë pa TVSH

2. Operatorin Ekonomik: “G & L CONSTRUCTION” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **L61901013N**
Vlera: **121 963** (njëqind e njëzet e një mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e tre) **lekë pa TVSH**

Janë s’kualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatorin Ekonomik: “G & L CONSTRUCTION” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **L61901013N**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtëm:

❖ Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik, shoqëria “G & L CONSTRUCTION” Sh.p.k., për pjesëmarrje në tender, rezulton se nuk përmbush të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret e Veçanta të Pranimit/ Kualifikimit, si më poshtë:

I. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 1 gërma “b”/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:
“1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

b. Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar sipas Shtojcës 1/1;”

➤ Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se: *në Deklaratën për paraqitje oferte të pavaruar sipas Shtojcës 1/1, pika 6 e saj, nuk është deklaruar mënyra e përgatitjes së ofertës (duke klikuar një nga alternativat).*

II. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 1 gërma “c”/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:
“1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

c. Sigurimin e ofertës, sipas Shtojcës Shtesë;”

➤ Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk ka paraqitur sigurimin e ofertës, *sipas Shtojcës Shtesë kërkuar në DST.*

III. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.1/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

“2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës së fondit limit që prokurohet.

Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme :

a) *Në rastet e përvojës së ngjashme të realizuara me institucione shtetërore.*

- *Vërtetim i lëshuar nga institucioni përkatës dhe faturat tatimore të shitjes ku të jetë e përcaktuar koha e shërbimeve, vlera e realizuar si dhe vërtetim e realizimit me sukses të kontratës.*

b) *Në rastet e përvojës së ngjashme të realizuara me subjektet private.*

- *Faturat tatimore shitjeje ku të jenë të shënuara saktë datat, shërbimet e realizuara, sasi të shumta si dhe emri dhe nënshkrimi i personit blerës.”*

➤ Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi referuar dokumentacionit të paraqitur, konstatohet se kontrata e shërbimit është nënshkruar si bashkim operatorësh ekonomikë, dhe se nuk jepet informacion për % (përqindjen) e pjesëmarrjes në shërbimin e kryer nga ana Juaj si kontraktues.

IV. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.6/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

“2.3.6 Operatori ekonomik duhet të disponojë minimumi 1 (një) automjet, të cilin duhet ta ketë në pronësi, huapërdorje ose me qira, dhe për të cilin duhet të paraqesë dokumentacionin përkatës, si më poshtë:

a) Dokument që vërteton pronësinë ose huapërdorjen ose qiramarrjen si më poshtë:

- Dokumentacioni që vërteton pronësinë: Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj; ose kontrata e shitblerjes; ose kontrata e dhurimit; ose çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

- Dokumentacioni që vërteton huapërdorjen: Kontratë huaje.

- Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira: Kontratë qiraje.

b) Leje qarkullimi e mjetit.

c) Certifikatë e kontrollit teknik të mjeteve rrugore,

d) Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve,”

➤ **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk është paraqitur Çertifikata e kontrollit teknik të mjetit rrugor, ku referuar lejes së qarkullimi ka përfunduar më datë 28.04.2021.**

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Informojmë Operatorin Ekonomik: **“NOVATECH STUDIO”** Sh.p.k, me seli: *Tiranë, Njësia Bashkiake nr.8, rruga “Shenasi Dishnica”, nr.pasurie 10/221+1- 18, zona kadastrale 8370, hyrja 1, ap 18*, me numër Nipt-i: **L01717030C**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej: **116 747.9** (njëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e dyzet e shtatë pikë nëntë) **lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Bashkisë Mat** (Sektorit Juridik dhe Prokurimeve Publike), me adresë: *Sheshi “Ahmet Zogu”, Nr.1, KP 8001, Burrel*, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda **5 (pesë) ditëve** nga momenti i përfundimit të afatit të ankesave prej 7 (shtatë) ditësh nga publikimi i njoftimit të fituesit në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE) faqja zyrtare e APP-së/ ose dhënies së një vendimi përfundimtar për ankesën (në rast se do të ketë).

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, dhe do të procedohet konform dispozitave ligjore në fuqi të parashikuara nga Ligji nr. 162/2020 *“Për prokurimin Publik¹”*.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: **28.05.2021**

Ankesa: **Ankesa për dokumentet e tenderit nuk ka patur.**

Titullari i Autoritetit Kontraktor